



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Mr. Laura Kryeziu

Kryetare e Këshillit Drejtues të UP-së

Nr. Prot.: 845

Datë: 28/3/2019

Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", shqyrtoi kërkesë Nr. 05/208 të datës 31.1.2019, të parashtruar nga Mersije Bimbashi, ish bibliotekistë në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", për kompensim të pagave pas pensionit, Në mbledhjen e mbajtur me datën 07.03.2019 merr, këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pa bazuar kërkesa me nr. prot: 05/208 të datës 31.1.2019, të parashtruar nga Mersije Bimbashi, ish bibliotekistë në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", për kompensim të pagave pas pensionit dhe atyre të shpërblimit jubilar.
- II. Vlen vendimi mbi pensionimin ku e përmendura është pensionuar sipas vendimin me nr. 623 dt: 9.3.2018, dhe është njoftuar se në bazë të nenit 19 pika 2 e Rregullores për shtesa në pagë dhe kompensime tjera të nëpunësve civil, e miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës i takon vetëm një pagë pas pensionimit.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe është përfundimtar për organet e UP-së.

A r s y e t i m

Këshilli Drejtues, në mbledhjen e mbajtur më 07.3.2019, pasi shqyrtoi kërkesën Nr. 05/208 të datës 31.1.2019, të parashtruar nga Mersije Bimbashi, ish bibliotekistë në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", për kompensim të pagave pas pensionit dhe atyre jubilar, ku e përmendura ka arrite moshën e pensionimit me datë 07.08. 2018 dhe është njoftuar se në bazë të Rregullores nr. 33/2012 për shtesa në pagë dhe kompensime të tjera të nëpunësve civil, përkatësisht Neni 19 pika 2 e kësaj Rregullore thekson se kompensimi pas pensionimit nëpunësit i takon vetëm një page, andaj edhe të përmendurës ju është njohur e drejta e një page në vlerë të pagës së fundit. KD-konsideroi se kontrata kolektive nuk ka karakter detyrues dhe atë duke u mbështetur në praktikën e institucioneve të tjera shtetërore të cilat nuk e kanë zbatuar asnjë herë kontratën kolektive të punës sepse një kontratë e tillë e nënshkruar në mes partnerëve social ka kërkuar edhe ndarjen e kostos së lartë buxhetore, të cilën qeveria e Kosovës nuk e ka paraparë për as një institucion.

Për shkak të karakterit që kanë kontratat kolektive lidhen për kohë të caktuar dhe atë më së shumti për periudhën deri në tri vjet. Prandaj afati i Marrëveshjes Kolektive ka skaduar për implementim, palët të cilat e kanë lidhë kontratën mund që me marrëveshje ta zgjasin afatin e vlefshmërisë së kontratës ose që të lidhin kontratë të re.

Nga kjo rezulton se në kohën kur Mersije Bimbashi është pensionuar, kontrata kolektive nuk ka pasur fuqi juridike sepse afatëshmeri i ka përfunduar me 1 janar 2018, ndërsa e përmendura është pensionuar me datë 07.08. 2018, me këtë mund të thuhet se nuk ka efekt retroaktiv e njëjta kontratë që ju ka referuar profesoresha në kërkesë.

Andaj Njëri nga partneret social e që është Oda Ekonomike e Kosovës, është tërhequr tre muaj më herët para se të përfundoj marrëveshja e kësaj kontrate, me arsyetimin se palët nënshkrues nuk kanë gjetur zbatimin e saj. Me këtë rast edhe ligji e parasheh se ndonjëri nga palët nënshkruese tërhiqet atëherë nuk mund të zbatohet ajo kontratë.

- *Shkresa nga OEK drejtuar Qeverisë së Rep. Kosovës përkatësisht MPMS me nr. 392 datë 15.09.2017 dhe*
- *Shkresa nga Këshilli Drejtues i Odës Ekonomike të Kosovës me nr. 783 dt: 12.12.2014*

Procedurat për lidhjen e Marrëveshjes së Kolektive, mund të fillojnë më nismën e cilësdo palë kontraktuese, së paku tre (3) muaj para skadimit të vlefshmërisë së Marrëveshjes Kolektive. Çka një gjë e tillë nuk është bërë në mes parterëve të kësaj kontrate. Andaj edhe sikur institucionet tjera edhe UP-ja për të gjithë shërbyesit civil që kanë arrit moshën e pensionimit është duke e zbatuar Rregulloren për shtesa në pagë dhe kompensime tjera të nëpunësve civil, përkatësisht nenin 19 pika 2 e kësaj Rregullore e miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Prandaj mbi këtë bazë KD-ja vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala mund të ushtrojë ankesë pranë Gjykatës kompetente në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit (në kopje fizike apo elektronike) të këtij vendimi.

Ky vendim t'u dërgohet:

1. Arkivit të UP-së;
2. Parashtruesit të Kërkesës;
3. Asistentes së KD-së;
4. Zyrës Ligjore të UP-së.
5. Uebfaqe të UP-së



Këshilli Drejtues i UP-së

Mr. Laura Kryeziu – Kryesuese